

Prot. n. 2330619/21

29/07/2021

E nderuar Zonjë, I nderuar Zotëri,

duke filluar nga muaji tetor zhvillohet Censusi i përhershëm i popullsisë dhe i banesave, realizuar nga Istat - Instituti Kombëtar i Statistikës.

Nga viti 2018 Censusi organizohet ndryshe nga e kaluara: çdo vit marrin pjesë grupe qytetarësh të caktuar me kriter rastësor midis familjeve rezidente në Komunat që bëjnë pjesë në kampion.

Rilevimi, që përfshin familjen tuaj, do të bëhet nga **14 tetor** deri **18 nëntor 2021**.

Të dhënat e kërkuara do të shërbejnë për të njohur karakteristikat kryesore demografike e sociale të popullsisë të vendit tonë, numrin e banesave dhe karakteristikat e atyre të banuara.

Istat e bën këtë rilevim dhe trajtimin përkatës të të dhënave personale duke kryer një detyrë me interes publik. Rilevimi i Censurit parashikohet në fakt nga Rregullorja europiane n. 763/2008, nga ligji n. 205/2017, dhe hyn në Programin statistikor kombëtar në fuqi (kodi IST-02493), që parashikon, për këtë rilevim, detyrim e mundësi sanksionimi.

Informacionet e mbledhura do të trajtohen duke respektuar normativën në lëmin e tutelës së sekretit statistikor e të mbrojtjes së të dhënave personale (shikoni seksionin "Trajtimi i të dhënave" në pjesën e pasme të letrës).

Për mbarëvajtjen e rilevimit dhe mbi të gjitha për t'i pasuruar të dhënat statistikore të dobishme për kolektivitetin, do të jetë thelbësor bashkëpunimi i plotë i familjes suaj.

Ju falënderoj për kontributin që do të jepni.

Firmosur nga Gian Carlo Blangiardo

UDHËZIME PËR T'IU PËRGJIGJUR PYETËSORIT

Rilevimi do të bëhet nga **14 TETOR** deri **18 NËNTOR 2021**.

Një rilevues komunal do të vijë pranë vendbanimit tuaj i pajisur me tablet e taserë identifikimi për të bërë intervistën.

Si alternativë, pasi t'i keni lënë rilevuesit disa informacione për të dhënat personale, familja juaj mund të vendosë që ta përpilojë në mënyrë autonome pyetësin duke përdorur tabletin e rilevuesit, ose mund të shkojë pranë Qendrave Komunale të Rilevimit (CCR), në punë për të gjithë periudhën e rilevimit, ku mund ta përpilojë pyetësin në mënyrë autonome ose nëpërmjet intervistës së drejtuar nga një operator komunal.



UDHËZIME E NDIHMË

- Kontaktoni Numrin e Gjelbër Istat 800.188.802, aktiv çdo ditë nga 1 tetor deri 18 nëntor 2021, nga ora 9.00 deri në orën 21.00
- Shkruani në adresën e postës elektronike censimentipermanenti.popolazioneeareale@istat.it
- Konsultoni faqen internet të Istat në adresën <https://www.istat.it/it/censimenti-permanenti/popolazione-e-abitazioni>

